

Fjalat e Paqes



"Pse po trembeni?
Pse po dyshoni
në zemrat tuaja?
Shikoni duart e mia
e këmbët e mia:
Unë jam!"

Lk 24, 38-39

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult **Nr. 2 (139) Viti XX Shkurt - Mars 2018**

... është Pashkë!

Arqipeshkvi, meshtarët,
rregulltarë e rregulltare
çdo të pagëzuari në Krishtin,
duke thirrur: "Krishti u ngjall!"
urojnë ...
për shumë mot Pashkët 2018



A
L
e
L
u
j
a

2 Imzot Angelo Massafra
Urimi i Pashkëve 2018

4 Shugurime diakonale

6 Agron Gjekmarkaj
"A do të kthehet Skënderbeu?"

7 Seminari Ndërdioqezan Shqiptarë
Dita e Seminarit

8 Reflektim nga aksidenti tragjik në Velipojë
"Çdo vdekje varfëron"

10 Armando Cungu
"Sporti, dobia e tij"



Imzot Angelo Massafra O.F.M.
Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pultit

Krishti u ringjall, aleluja!

Ky urim i Pashkëve 2018 është i njëjti urim që Krishti, pikërisht ditën e Ringjalljes së vet prej të vdekurve, ua drejton nxënësve të vet të mbledhur në Çenakullin e Jerusalemit: “Paqja me ju!”.

Është një urim paqeje dhe shprese drejtuar njerëzve të frikësuar e të tronditur nga ngjarjet e trishtuara të mundimeve të tij dhe që jo vetëm kishin shkaktuar tmerr, por edhe kishin minuar sigurinë që kishin ndërtuar gjatë viteve në të cilat kishin shoqëruar Jezusin në misionin e tij dhe, tani, ndiheshin jetimë e pa arsye për ta vazhduar atë që kishte filluar Mësuesi i tyre.

I Ringjalluri i ka shumë për zemër nxënësit e vet: kujdeset për ta dhe u del përpara.

“Ne shpresonim...” i përgjigjen dy nxënësit që po ecnin drejt Emausit Jezusit që u afrohet atyre gjatë udhëtimit që është duke i çuar larg vendit ku kishte ndodhur vdekja e turpshme e Mësuesit të tyre. Dhe Jezusi u shpjegon atyre kuptimin e Shkrimeve të Shenjta që kishin lidhje me të dhe u jep zemër, por jo pa i qortuar më parë: “O të pamend e të ngadalshëm që të besoni gjithçka paralajmëruan profetët!”.

Por ata, në vend që të acarohen, ndiejnë t'i ndizet zemra në kraharor; tashmë është mbrëmje dhe prej zemrës së tyre buron lutja plot besim: “Rri me ne se u bë natë e dita po shkon në të sosur”. Ja: ka rilindur shpresa, jo më e bazuar në pritshmëri vetëm njerëzore, por në një fjalë hyjnore që ngushëllon dhe hap para perspektivave të reja.

Në tryezë me Jezusin dhe në gjestin e thyerjes së bukës sytë e tyre hapen dhe në Udhëtarin misterioz njohin shokun e rrugës së të gjithë njerëzve të të gjitha kohëve dhe, të fortë prej pranisë së tij (edhe pse Ai zhduket prej syve të tyre), ndërmarrin rrugën në drejtimin e kundërt: Jerusalemi tashmë nuk është vend i vdekjes, por pikënisja e jetës së re të përruruar prej të Ringjallurit, nxënës dhe misionarë të të cilit janë tani me të vërtetë.

Shumë të dashur vëllezër e motra, përvoja e nxënësve të Emausit është ajo që e bëjmë të gjithë ne gjithmonë, sepse gjithmonë gjendemi përballë efekteve të zgjedhjeve të mëkatit e vdekjes që bëjmë ne vetë apo të tjerët. Frika dhe zhgënjimi mund të na bllokojnë, ta shterin shpresën, të na bëjnë të ikim. Por Zoti i Ringjallur bëhet shoku ynë i udhëtimit për të na bërë të kuptojmë nevojën

për t'i mbështetur pritshmëritë tona dhe shpresat tona vetëm në Të.

Prandaj, ndërsa ju uroj paqen e të Ringjallurit, ju ftoj ta pranoni me gëzim qortimin e Jezusit për fenë tonë të pakët në Të; ju ftoj të viheni të gjithë në dëgjim të Shkrimeve të Shenjta për ta kuptuar më mirë identitetin e tij, në dritën e të cilit do ta kuptojmë më mirë edhe identitetin tonë; ju ftoj në lutjen e përvuajtur, që të përsërisni me gjithë zemër atë “Rri me ne!” për të cilën kemi shumë nevojë; ju ftoj të mblidheni në tryezën e së dielës për të thyer e konsumuar së bashku bukën e jetës së pasosur që është vetë Jezusi. Të nxitur kështu do të fillojmë së bashku një ecje të re, me energji të reja, me një shpresë të re, atë që vetëm Jezusi i Ringjallur mund të na e dhurojë.

Ky është ilaçi për çdo formë shkurajimi që mund të na pushtojë kur mbetemi të zhgënjyer prej pritshmërive të parealizuar të çdo lloji: politik, shoqëror, ekonomik, moral.

Në lidhje me këtë, të mos harrojmë se këto Pashkë na vendosin brenda Vitit Jubilar për 550-vjetorin e vdekjes së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, shpirti i të cilit dhe dashuria e të cilit për Krishtin dhe për Atdheun e vet janë ende gjallë dhe të pranishëm në shpirtin e çdo shqiptari. Kujtimi i tij nuk mund të kufizohet thjesht në një kremtim të shterpë të së kaluarës, por duhet të bëhet një rast më shumë për ta dashur Tokën tonë dhe Atdheun tonë, Shqipërinë tonë “të varfër e të bukur”, tokë Martirësh të Fesë dhe të shumë dëshmitarëve të Atdheut që na nxisin e na shtyjnë të jetojmë angazhimin konkret për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë.

Edhe kjo, sidomos për ne të krishterët, do të thotë të jetojmë si të ringjallur së bashku me Krishtin. Me Krishtin dhe në Krishtin mund dhe duhet të jemi gurë të gjallë; pra qytetarë aktivë, të ndershëm dhe punëtorë të guximshëm për rindërtimin shpirtëror, moral, kulturor dhe ekonomik të Atdheut tonë të dashur.

Prandaj, le të largojmë çdo shkurajim; të kemi besim në Jezusin, të kapemi pas Tij me fe dhe një shpresë e re do të lindë.

Krishti i Ringjallur është shpresa jonë. Ju uroj me gjithë zemër: gëzuar e për shumë mot Pashkën!



Ati i shenjtë, Françesku, në kremtimet e Javës së Madhe, të Vigjiljes së Pashkëve, dhe të së kremtes së Pashkëve, duke medituat Fjalën e Zotit dhe Veprën shpëtimtare të Krishtit shëlbues, i shpalli njerëzimit të vërtetën e madhe se nuk do të na braktisë i miri Zot!

Një grup lexuesish të një të përditshmeje në Itali “Corriere della sera”, në personin e drejtorit të saj dr. Franco, i janë drejtuar me një letër, Shejtërisë së Tij, Papa Benediktit XVI, në të cilën shprehin interesin e tyre për gjendjen e tij. Papa emeritus, Benedikti XVI, i përgjigjet redaksisë së “Corriere della sera” me një letër të tijën ku thekson se në këtë pjesë të fundit të shtegëtimit të tij në këtë botë e ndien veten në rrugë për në shtëpinë e Atit dhe të rrethuar më dashuri dhe mirësi.

Më poshtë letërpergjigjja e Papa Benediktit XVI



“I nderuari Dr. Franco,


Më preku shumë që shumë lexues të gazetës Suaj dëshironin të dinin se si e kaloj këtë periudhë të fundit të jetës sime. Në këtë drejtim mund të them vetëm se, në rënien e ngadaltë të forcave fizike, përbrenda unë jam në shtegëtim drejtë Shtëpisë (qiellit). Është një hir i madh për mua të rrethohem, në këtë pjesë të fundit të rrugës, që nganjëherë është pak e lodhshme, me dashuri dhe mirësi të tillë që nuk mund ta kisha imagjinuar. Në këtë kuptim, unë gjithashtu e konsideroj interesin e lexuesve tuaj si një shoqërim për këtë pjesë rruge. Kjo është arsyeja nuk mund të mos ju falënderoj, dhe t’iu siguroj nga ana ime të gjithë juve lutjen time. Përsëritet të përzemërta”.

Benedikti XVI

Komunikata e Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar, 06.02.2018

Siç është bërë e ditur, gjatë lutjes “Angelus”, të dielën më 4 shkurt, Shenjtëria e Tij Papa Françesku ka shpallur të premtën më 23 shkurt një Ditë lutjeje dhe agjërimi për paqen, në veçanti për popullsitë e Republikës Demokratike të Kongos dhe të Sudanit Jugor.

Ati i Shenjtë ka ftuar edhe anëtarët e besimeve të tjera që t’i bashkohen kësaj nisme, në format që do t’i konsiderojnë më të përshtatshme. Këshilli Papnor për Dialogun Ndërfetar, i vetëdijshëm se besimet mund të ndihmojnë shumë në arritjen dhe në përforcimin e paqes, do t’u jetë mirënjohës vëllezërve e motrave të besimeve të tjera që do të duan ta pranojnë këtë thirrje dhe të jetojnë momente lutjeje, agjërimi dhe reflektimi sipas traditës së tyre dhe në vendet e tyre të kultit.





Motër Mimoza Jaku

Për Kishën katolike, 22 shkurti gjithmonë është një festë e veçantë, sepse festohet Selia e Shën Pjetrit. Përveç të tjerash, kjo festë na ndihmon të kuptojmë edhe rëndësinë e Urdhrit të Shenjtë. Pikërisht në këtë ditë kaq të rëndësishme dy të rinj, seminaristët Gentian Sema dhe Kristian Marku të dioqezës sonë kanë marrë shkallën e parë të Urdhrit të shenjtë, diakonatin. Kjo shërbesë, njeriun e shuguruar e bën më të përafërt me Krishtin nëpërmjet veprimit që ata do të kryejnë në Kishën shenjte. Ky hirë i shugurimit i dhënë atyre bëhet mjet shprese dhe dashurie për ripërtërirjen e krejt Kishës së shenjtë.

Në meshën e 22 shkurtit pasdite, në Katedralen e Shkodrës, Sh.T. Imzot Angelo Massafra, në bashkëkremtim e Sh.T. Imzot Simon Kulli, Ipëshkëv i Sapës dhe me një numri të madh meshtarësh të ardhur nga dioqeza të tjera të Shqipërisë, shuguroi Gentianin dhe Kristianin. Riti i urdhrit të shenjtë, bëhet një itinerar i ri feje dhe shprese, për këta diakon dhe jo vetëm kaq, por mbi të gjitha se ata nuk do t'i përgjigjen Zotit thjesht me një "po" momentale, verbale, por një "PO" që është përgjegjësi dhe detyrim për shenjtëri. Pikërisht ashtu sikurse edhe e theksoi Sh.T. Imzot Angelo Massafra gjatë homelisë së tij që e mbajti me këtë rast: *"Shën Pjetri të jetë model i jetës suaj si diakon, dhe më pas si meshtarë kur do të jeni të shuguruar meshtarë. Koha e diakonatit është një dhuratë që Zoti i bën Kishës sonë. Shërbesa e diakonatit është një dhuratë e Shpirtit shenjtë, sepse nëpërmjet kësaj shërbesë i riu do të bëhet dita-ditës si Krishti, i cili erdhi për të shërbyer e jo për të qenë i shërbyer. E për të qenë shërbëtor duhet të kemi një zemër të pastër, të butë e të përvujtë. Në të gjitha dhuratat që njeriu ka, përvujtëria do të jetë dhurata më e madhe. Sepse nëpërmjet përvujtërisë njeriu hyn në zemrën e njerëzve dhe Zoti me kënaqësi banon në zemrat e buta dhe të përvujta".*

Ja si e bashkëndajnë me ne diakonat e ri këtë dhuratë që Zoti ka bërë për ta:



Unë, dom Gentian Sema kam lindur në qytetin Vlorës. Shkollën fillore dhe të mesme e kam kryer në qytetin e lindjes. Në moshën njëzet vjeçare kam shkur në Itali si emigrant. Rreth dhjetë vite kam jetuar në atë shtet duke punuar. Në atë kohë më

është forcuar dëshira duke rikujtuar thirrjen e parë për të hyrë në seminar për tu bërë meshtarë. Jam kthyer nga Italia për të filluar Seminarin në Shkodër, si seminarist i dioqezës së Shkodrës. Kam kryer studimet Filozofike-Teologjike pranë Seminarit Ndërdioqezan Nënë e Këshillit të Mirë Shkodër dhe me datën 22 shkurt 2018 jam shuguruar diakon nga Shkëlqësia e Tij monsinjor Angelo Massafra, në katedralen e Shkodrës.



Unë, dom Kristian Marku kam lindur në famullin e Jubanit, fshati Ganjollë. Në Juban kam kryer shkollën fillore. Shkollën e Mesme e kam përfunduar në Mjedë. Mbas shkollës së Mesme kam filluar Seminarin si seminarist i dioqezës së Shkodrës. Kam kryer studimet Filozofike-Teologjike pranë

Seminarit Ndërdioqezan Nënë e Këshillit të Mirë Shkodër dhe me

Shugurime diakonale



datën 22 shkurt 2018 jam shuguruar diakon nga Shkëlqësia e Tij Imzot Angelo Massafra, në katedralen e Shkodrës.

Ashtu sikurse Tradita e Kishës e parasheh, të gjithë të kushtuarit përpara se të marrin një angazhim të tillë, duhet të bëjnë betimet, të cilët dëshirojnë që prej atij momenti t'i përkasin plotësisht Zotit duke ja dhuruar atij krejt jetën. Ato betime që ne kemi bërë na sjellin edhe një herë në vetëdijen tonë, që ne nuk i përkasim më botës, por i përkasim plotësisht Krishtit, sepse Zoti është pjesa e trashëgimit tim. Në rend të parë kemi bërë premtimin e dëshmisë së fesë. Në praninë e popullit të Zotit dhe të Ipeshkvit si dhe të dëshmitarëve kemi shpallur, që besojmë ngultazi në të gjitha të vërtetat që përfshihen në Simbolin e fesë, besojmë ngultazi në gjithçka që përfshihet në Fjalën e Zotit, dhe në Magjisterin e Kishës. Në rend të dytë kemi bërë premtimin e besnikërisë. Ne kemi marrë përsipër detyrën që do të ruajmë gjithmonë bashkimin me Kishën Katolike, qoftë me fjalët tona qoftë edhe me të vepruarin tonë. Jemi betuar se do t'i përmbahemi të ndihmuar nga hiri hyjnor gjithçka që disiplina e Kishës shpallë. Në rend të tretë kemi bërë premtimin e celibatit. Një zgjedhje të cilën e kemi bërë jo të shtyrë nga ndonjë detyrim, dhunë apo frikë, por me vullnet të lirë, të bindur se jemi të thirrur vërtet nga Hyji. Këto premtime i kemi bërë duke u betuar në Ungjill, duke vendosur duart tona mbi to. Secili prej nesh i kemi bërë premtimet në famullin përkatës. Unë dom Gentian Sema i kam bërë në famullin e Gurit të Zi, me datën 20 shkurtë, aty ku shërbej prej katër muajsh. Ndërsa me datën 21 shkurtë unë dom Kristian Marku i kam bërë në famullin e lindjes, në Juban. Me datën 22 shkurt kemi pasur edhe shugurimin tonë diagonal në Katedralen e Shkodrës.

Edhe një herë e ndiejmë shumë përzemër të falenderojmë Zotin për këtë dhuratë që na ka bërë, duke na bërë shërbëtorë të Tij më të ngushtë, në shërbimin e altarit. Dhe kemi shumë dëshirë me falënderuar të gjithë ato që janë angazhuar për formimin tonë ndër këto vite në Seminar.

Lutuni për ne.





Lajme nga CCEE - Këshilli i Konferencave Ipeshkvore të Evropës

Takimi i V i delegatëve kombëtar për marrëdhëniet me myslimanët në Evropë, Shkodër, Shqipëri, 7-9 shkurt 2018.**“Për një mistikë vëllazërie përmes përshtetërisë”.**

Në Shqipëri, vend që dikur deklarohet shtet ateist, religjionet sot jetojnë një përvojë të mirë bashkekzistence që i jep shpresë dialogut ndërfaqet. Duke shkuar në Shkodër, me ftesë së Arqipeshkvit të vendit, Imzot Angelo Massafra OFM, në 25° vjetorin e vizitës historike të Shën Gjon Palit të II-të (25 prill 1993), delegatët kombëtar për marrëdhëniet me myslimanët dëshmojnë interesin dhe punën kapilare të Kishës Katolike për dialogun me myslimanët në Evropë. Në këto tre ditë pune, delegatët e konferencave ipeshkvore janë ballafaquar rreth figurës së besimtarit mysliman dhe kanë diskutuar disa çështje baritore.

Kisha në Evropë është e angazhuar në dialog me bashkësitë e ndryshme myslimane në nivele të ndryshme (akademike, fetare dhe sociale, por edhe dogmatike, juridike dhe shpirtërore). Dialogu nuk është një aspiratë, por një përvojë e përditshme me gëzimet dhe sfidat e tija.

Në Shqipëri, pjesëmarrësit kanë njohur një realitet që jeton praninë e bashkësive fetare të ndryshme në një harmoni ndërtuese. Vuajtja mizore e përvojës së regjimit totalitarist, që ka imponuar një ateizëm shtetëror, ka sjellë afrimin e të gjithë besimtarëve, duke bërë që të pikt një ndjenjë e madhe tolerance dhe respekti me besimtarëve të religjioneve të ndryshme. Shqipëria është një Vend që jeton mistikën e takimit. Është bash kjo karakteristikë tërësisht shqiptare që i ka nxitur delegatët kombëtar, të mbledhur në takimin e pestë, që të vendosin të thellojnë temën e takimit mistik, duke promovuar “dialogun e përshtetërisë”. Në Shkodër, pjesëmarrësit janë angazhuar që të përforcojnë kontaktet me bashkësitë myslimane edhe në nivel përshtetërie. Në mbështetje të kësaj harmonie si dhe në angazhimin për nxitjen dhe promovimin e kësaj shenje dalluese bashkëjetese, përshëndeti edhe Kryetaria e Komitetit Shtetëror të Kulteve, znj. Loreta Aliko.

Një pjesë e punimeve i është kushtuar për të shënuar profilet themelore të besimtarit mysliman dhe mënyrat përmes të cilave [ai] jeton lidhjen e tij me Zotin. Tema është thelluar me kontributin e dy përfaqësuesve të bashkësisë myslimane të pranishme në Shqipëri: një imam sunit dhe lideri i bashkësisë Bektashiane të Vëndit. Pjesëmarrësit në debat nënvizuan rolin e lirisë, jo vetëm në nivel të zgjedhjes fetare, por edhe në nivel të mënyrave me të cilat besimtari ka ndër mend të jetojë lidhjen e tij me Zotin në brendësi të vetë familjes fetare: mënyra këto të gjitha të drejtuara kah liria e un-it për t'ia arritur bashkimit me Hyjin. Në traditën sufi kjo vjen përmes shoqërimit të një mësuesi shpirtëror. Besimtari është pjesë përbërëse e një rrugëtimi bashkësor dhe kurrë individualistik. Ky rrugëtim i brendshme, që shkon deri në thellësinë e zemrës njerëzore, vend intim dhe i përveçshëm i dialogut me Zotin, i shpije të krishterët dhe myslimanët ta pranojnë veten si pjesë përbërëse e të njëjtës bashkësi të krijuar nga Hyji. Dhe bash aty, dialogu, në veçanti ai i jetës dhe i përshtetërisë, mund të zhvillohet dhe të bëjë që të rriten marrëdhënie të vërteta miqësie dhe vëllazërie.

Më vonë, pjesëmarrësit, kanë thelluar tre pjesë baritore që përfshijnë marrëdhëniet me myslimanët: i pari, duke ardhur nga Austria, pa paraqitjen e rrugëtimin të katekumenatit për t'i pranuar myslimanët që kanë kërkuar pagëzimin. I dyti që një thellim i përvojës shpirtërore duke u nisur nga ajo që ka jetuar Imzot. Claude Rault, Ipeshkëv emerit (në pension) i Laghouat Ghardaïa-së, në Algjeri. Imzot Rault ishte bashkëthemelues me at' Christian de Chergé (epor i murgjve trapistë të Tibhirine-s) i iniciativës Ribat al Sala (Lidhje paqeje) me të cilën një grup i vogël të krishterësh ka zhvilluar dialogun e përshtetërisë me miqtë myslimanë dhe bashkëvëllazërinë sufite të Medeas. Në fund është paraqitur përvoja franceze e shoqërimit të çifteve të përziera krishtero-myslimane që përbëjnë në vetvete një vend dialogu ndërfaqet dhe që janë një sfidë baritore që duhet ndjekur.

Gjatë takimit është lexuar edhe mesazhi që kardinali Jean-Louis Tuaran, Prefekt i Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar, u ka dërguar pjesëmarrësve dhe në të cilën i ka ftuar “të krishterët dhe myslimanët, që të promovojnë respektin reciprok, objektivitetin në të folur dhe në të shkruar mbi religjionin tjetër, dashamirësinë, zemërdhembshurinë dhe mëshirën”.

Në Shkodër, delegatët ndërkombëtar kanë vizituar Xhaminë e Madhe të qytetit, kuvendin e motrave Klarise, ish-kuvend françeskan i shndërruar në burg për të burgosurit e Shtetit gjatë regjimit, dhe muzeun dioqezan që përmban dëshmi të ndryshme të 38 martirëve shqiptar.

Punët u mbyllën me një paraqitje rreth statutit teologjik të Islamit në refleksimin e krishterë bashkëkohor, temë që është dorëzuar nga Koncili i II-të i Vatikanit dhe që hap prospektiva të reja për t'i thelluar përvojat e dialogut të lindura dhe të jetuara në mbarë Evropën. Në ditën përmbyllëse, Imzot Brendan Leahy D.D., Ipeshkëv i Limerick dhe përgjegjës i seksionit Dialogu Ndërfetar i Komisionit Ungjillëzim dhe Kulturë i CCEE-së, udhëhoqi Meshën Shenjte në Katedralen e Shkodrës dhe paraqiti disa refleksime në mbyllje të takimit.

Takimi u mbyll me vizitën në Shenjtëroren e bektashinjve, në Krujë, qendër përshtetërie të njëjtës vëllazërie.

Gjatë ditëve të punimeve të takimit të 5° të delegatëve nuk mungoi edhe prania ipeshkvij të Konferencës Ipeshkvore Shqiptare, të klerit, rregulltarëve dhe rregulltarëve.

CCEE - Këshilli i Konferencave Ipeshkvore të Evropës aktualisht përfshin 33 Konferenca Ipeshkvore Evropiane, të përfaqësuara nga Presidentët e tyre, nga Arqipeshkvi i Luksemburgut dhe i Principatit të Monakos, nga Arqipeshkvi i Qipros i Maronitëve, nga Ipeshkvi i Chişinău (Republika Moldave), nga Ipeshkvi eparkial i Mukachevo-s dhe nga administratori apostolik i Estonisë. President aktual është Kardinali Angjelo Banjasko, Arqipeshkëv i Xhenovas, Zëvendës President janë Kardinali Vincent Nichlos, Arqipeshkëv i Ëestminster-it, dhe Imzot Gądecki, Arqipeshkëv i Poznań. Sekretar i Përgjithshëm i CCEE është Imzot Duarte da Cunha. Sekretaria e ka selinë në San Gallo (Svicër).

dom Gjovalin Simoni

Drejtor i Qendrës Kombëtare për Thirrjet



“Në Fjalën Tënde o Zot, po i hedh rrjetat...”

Nga 28 shkurti deri me 03 mars 2018, është mbajtur në Tiranë Kongresi Evropian mbi Thirrjet, i organizuar nga Këshilli i Konferencave të Kishave në Evropë dhe Qendra Kombëtare për Thirrjet në Shqipëri. Takimi u mbajt në përgatitje të Sinodit të ardhshëm të Ipeshkëvjve me temë: “Rinia, feja dhe shoshitja thirrore” që do të mbahet në Vatikan në tetorin e këtij viti. Ky takim është organizuar dhe ftuar mbi të gjitha me iniciativë të Mons. Ottavio Vitale, Ipeshkëv i Lezhës.

Takimi pati si pikënisje 20 vjetorin e botimit të dokumentit mbi promovimin e thirrjeve në Evropë të vitit 1997, “In Verbum Tuo”- “Në Fjalën Tënde”. Në këtë takim ishin të pranishëm të gjithë delegatet e kishave evropiane të cilët në ditën e parë paraqiten secili gjendjen e thirrjeve në kishat e tyre.

Të ndihmuar nga relatorët si Padre Amedeo Cencini dhe P. Fabio Attard, u anilizua shumë situata gjeografike, sociologjike dhe shpirtërore e Kontinentit të vjetër evropian. Jo pa qëllim padre Cencini provokoi disa herë me nxitjet e tija: “Thirrje të reja për një Evropë të re”. Ndërhurjet e relatorëve mbajtën të ndezur shpresën se në Evropë po punohet për të ngjallur më shumë mënyrë dhe forma të reja për të pasur thirrje.

Shumë domethënëse ishte edhe relacioni i Sh. T. Imzot Jorge Carlos Patron Ëong, sekretar për Seminaret pranë Kongregatës së Klerit i cili vuri theksin mbi dëshminë e gëzueshme që çdo i thirrur duhet të jetojë në jetën e vetë për të qenë kështu një mjet tërheqës për thirrje të reja.

Një vend të veçantë u kemi rezervuar miqve tanë nga Evropa, shtegtimin në qytetin e Shkodrës mbi gjurmët e Martirëve tanë, ku vizituan shenjtëroren e Zojës së Këshillit të Mirë, katedralen e shën Shtjefnit dhe muzeun dioqezan. Më pas, pasi panë sheshin në qendër të Shkodrës, shkuan në ish-burgun e Sigurimit, tashmë muze, pranë kuvendit të motrave klarise. Në orën 19.00, kremtimi eukaristik i kryesuar nga Imzot Angelo Massafra. Më pas i gjithë delegacioni shkoi në Seminar ku në një klimë vëllazërore e festive mbylli vizitën në Shkodër.

Duke uruar që ky takim të ketë fryte jo vetëm në Evropë por edhe në dioqezat tona në Shqipëri, lusim Zotin që të dërgojë punëtor në të korrat e veta.



Agron Gjekmarkaj

A do te kthehet Skënderbeu?

A do të kthehet Skënderbeu ?

Dikur në vitin e largët 1846 një udhëtar austriak viziton malet e veriut të Shqipërisë! Do të habitej i ngrati për atë që dëgjon nga takimi me një vendas i cili pyetjes pse nuk ngriheni kundër turqëve ai i përgjigjet “atë punë e di Skënderbeu, kur të kthehet ai atëhere po”. I çmeritur gjithëqysh i huaji i thotë “Skënderbeu ka vdekur, si do të kthehet, kur do të kthehet?”.

Malësori pa gajle ja kthen “Skënderbeu nuk vdes kurrë, se kur kthehet ai e di vetë nuk pyet as ty e as mua”. Në shumëçka amnezia e kujtesës gjatë natës otomane ishte një punë e kryer. Jo të shumtë ishin ata që ende e dinin se në Arbëri kishte patur një mot të lavdishëm e po kaq një prijës me emrin Gjergj Kastrioti Skënderbe. Atje mes malesh të larta ku turku shkelte rrallë, izolimi kthehej në një konservatorizëm sa religjioz e po kaq identitar. Sidomos në zonat katolike ku indi ushqehej me prelatë që shkolloheshin kryesisht në Itali, Skënderbeu dhe Jezu Krishti bashkoheshin në një si për të ruajtur njëri-tjetrin nga zhdukja në një tjetër trini: besim-histori-nevojë.

Do ta ketë ndier më shumë se kushdo peshën e rëndë të mjegullës që zinte çdo tejqyrë a komunikim prifti Frang Bardhi teksa brilant dhe i papërsëritshëm shkruante apologjinë për identitetin arbëror të Skënderbeut. Ky fakt dëshmon se mendjet e ndritura por të pakta të cilat do të ecnin ujdhesave të historisë do ti përcillnin njëri tjetrin unën e zjarrit të ndezur deri tek Rilindja Kombëtare e cila do të legjitimohej e frymëzohej prej bëmave të Gjergjit të madh.

Në kontinent ndodhte ndryshe! Të shumtë, kund, rreth 1800 sish dekadë, pas dekade, kohë pas kohe, shekull pas shekulli ishin librat që shkrimtarët e shumtë europian shkruajtën për të. E njohën për të vetin. Opera, drama, emra rrugësh, statuja nëpër sheshe, u kënduan, u interpretuan dhe u vendosën atyre qyteteve madhështore si mirënjohje për të. Po kështu ikanaket që morën detin me kumbona e pragje shtëpie duke u vendosur në Itali pas vdekjes së Skënderbeut njësoj si malësori i mësipërm e shndërruan në zot të cilit i kërkuan mbrojtje për gjuhën, doket dhe zakonet për mbi 550 vjet. Ai e pat atë fuqi që ti mbronte. Atyre rrepirave ku ndërtuan qytetet e tyre pa mëdyshje çdo sheshi i vunë emrin e tij. Kudo e gjen statujen e tij. Po kaq përmallshëm e gëzueshëm me këngë e valle i kujtohen betejat, legjendat që e rrethojnë, fisnikët që pat në krah.

Tek arbëreshë Skënderbeu është sa histori aq bashkohësi. Tek ata kështu ka ndodhur gjithmonë mbase falë kësaj ngjizje ata u shndërruan në fenomenin më unik të ruajtjes së identitetit kombëtar. Në vitin 2006 personalisht u gjinda pjesë e një delegacioni në Venecia ku merrnin pjesë shumë ministra të Europës Qëndrore e Jugore të ftuar të Roko Butiljones ministër italian i kulturës ku diskutohej për trashigiminë kulturore.

Butiljone teksa prezantonte Bujar Leskajn, homologun e vet shqiptar, rrëfeu se ishte lindur e rritur parni një fshati arbëresh dhe se ata njerëz nderonin si perëndi Gjergj Kastriotin. “Asokohe kisha vështërsi për ta kuptuar gjithë këtë misticizëm por me kalimin e viteve teksa investohesha në studime kuptova se nderimi ishte i merituar dhe sot unë kam të njëjtin nderim për të si ata fqinj të fëmijërisë time sepse Skënderbeu është një nga vlerat më të mëdha të kontinentit tonë dhe civilizimit Europian”.

Gjithësa thashë më sipër shërbejnë për të kuptuar paradoksin shqiptar që rrethon Skënderbeun.

Atë që nuk munden të bënin turqit figurës së tij, po mundohen t’ja bëjnë shqiptarët e tij në epokën e lirisë. Si dergje me daulle akixhinjësh i turren me lloj-lloj pretextesh. Shpesh e qortojnë me lehtësinë e të gjerburi shërbet se nuk duhet tu qëndronte turqëve. Disa i vënë në dyshim ekzistencën. Ca të tjerë thonë se në vend të statujes së tij të vëmë atë të sulltan Muratit. Aradha t’çartunish vikasin se nuk qënkeshe heroi i të gjithëve sepse ka qënë i krishterë a thua se kur ai ishte gjallë shqiptarët nuk ishin të gjithë të tillë. Po kaq si akixhinjë të mendimit me spazme ndoca kërkojnë ta demitizojmë se na mori frymën miti i tij. Çuditë shqiptare s’kanë të sosur. Skënderbeut në vendin e tij ende i duhet të

luftojë si në Berat e Albulenë ku tradhtohet nga të vetet, nga nipi Hamza.

Përtej të gjitha polemikave e dilemave plot dritëshkurtësi e dashakeqësi vetvrasëse që e shoqërojnë Skëndëbeun tash 106 vjet që kemi shpallur shtetin tonë qeveria shqiptare vitin 2018 e ka shpallur “Viti i Skënderbeut”. Muajt po kalojnë një nga një e ndonjë gjë e spikatur nuk po duket në horizont përveç një ekspozite me piktura socrealiste. Një vit kësisoj do të duhej të shërbente për të njohur më mirë vetveten duke u rikthyer tek Skënderbeu. Ai ka kaluar çdo lloj prove e testi në histori dhe ai ska nevojë për propagandë, madje ska nevojë për asgjë por ne kemi nevojë për të.

Kisha Katolike duhet të japë shembullin e para sesi mund të kujtohet Skënderbeu dhe epoka e tij ashtu si hungarezet veprojnë për Huniadin apo polaket për Mbretin Vladislav sëpaku tu bien kumbonave në datat dhe përvjetoret e betejave të tij. Në kohën e Mbretit Zog portreti i tij ishte kudo nëpër muret e shkollave. Ishte një traditë e bukur e domethënëse që duhet ringjallur. Por modeli i raportit me Kastriotin janë arbreshët por edhe i dobisë që ai sjell. Raporti shpirtëror me Skënderbeun është raporti me rrënjët, me vetveten, me identitetin, me shpirtin dhe hapsirën qytetërimore ku ai na vendosi dhe ai nuk realizohet me aksion siç mblidhen lekët për energjinë elektrike. Kjo ndodh kur shqiptarët ta përcaktojnë qartë se çfarë janë e ku duan të mbërrijnë. Kjo mbetet çështje e madhe edukimit dhe ideologjisë kombëtare. Nëse e njohin veten për pasardhës të Gjergjit dhe duan qytetërimin e tij sigurisht ai do të kthehet përsëri dhe do ti fusë nën mantel për të vazhduar sëbashku udhën. Të parin do të takojë atë malësin që ka besuar se ai gjithmonë do të kthehet edhe për inat të do shqiptarve që këtë vend e vjedhin e rrejnë dhe e shesin e që statujen e tij do ta benin skrap për 5 mexhite.

Bashkësia katolike e shqiptarëve, Romë

Figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut për vetë rëndësinë e saj historike dhe vlerat e larta që transmeton është e aftë të mbledhë rreth vetes e të frymëzojë akoma sot të gjithë shqiptarët e t’i bashkojë ato rreth vetes pavarësisht vendit në të cilin jetojnë. Aq më tepër kur bëhet fjalë për shqiptarët të cilët jetojnë në Romë, qytet me të cilin Skënderbeu pati një lidhje shumë të veçantë sidomos prej marrëdhënies që pati me Papën e asaj kohe i cili edhe e emëroi Athleta Christi.

Për këtë arsye Bashkësia Katolike Shqiptare në Romë më datë 25 janar, kremtoi një meshë në përkujtim të 550-vjetorit të kalimit në amshim të Gjergj Kastriotit. Mesha u kremtua nga përgjegjësi baritor për shqiptarët në Romë, dom Mark Pashkja, në kishën San Giovanni della Malva e cila është njëkohësisht edhe kisha ku bashkësia mblidhet çdo të diel dhe kremton eukaristinë në gjuhën shqipe. Në këtë meshë morën pjesë të gjithë meshtarët shqiptarë që studiojnë në Romë si edhe Rektori i Kishës e njëkohsisht përgjegjësi baritor i shqiptarëve në Itali Don Pasquale Ferraro. Po ashtu të pranishëm përveç besimtarëve të shumtë ishin edhe autoritetet më të larta të ambasadës shqiptare pranë shtetit italian dhe Selisë së Shenjtë. Gjithashtu një prani mjaft domethënëse ishte edhe ajo e ministrit të shtetit shqiptar për Diasporën, z. Pandeli Majko.

Në përfundimin e meshës në të cilën iu kushtua Zotit një lutje e veçantë për vendin tonë, Don Pasquale përshëndeti të gjithë të pranishmit duke ju uruar mireseardhjen dhe theksoi rëndësinë e figurës së Skënderbeut si figurë unifikuese për të gjithë shiptarët pa dallim. Pastaj Ministri Majko përshëndeti mbarë bashkësinë duke shprehur gëzimin e tij për praninë e tij në kishën tonë. Ai gjithashtu e konsideroi Gjergj Kastriotin si urën lidhëse të Shqipërisë me qytetërimin evropian dhe si njërin prej simboleve më të larta të identitetit evropian të Shqiptarëve.

Pas meshës dhe fjalimeve përshëndetëse pati edhe një moment festiv me elemente të traditës dhe kulturës shqiptare.

SEMINARI NDËRDIOQEZAN SHKODËR

Seminari Ndërdioqezan në Shkodër, është vend i posaçëm për formimin e meshtarëve të ardhshëm për Kishën në të gjitha trevat shqiptare. Seminari u hap më 2 gusht 1859, drejtohej nga Shoqëria e Jezusit. Komunizmi filloi të përhapej shpejt prandaj në vitin 1946 Seminari mbyllet për 47 vite rresht. Më 2 shkurt 1992, u rihap, tashmë me emrin “Nëna e Këshillit të Mirë”. Në Seminar një i ri përgatitet në aspektin e lutjes, ku ai mund ta ushqejë jetën e vet si krishterë, dhe më vonë si meshtar i Krishtit. Pas një shqyrtimi të thirrjes në vitin fillestar, të quajtur Propedeutik, kandidati ndjek shkollën e studimeve të larta, për 5 vite, si dhe viti i gjashtë i orientuar veçanërisht për punën baritore. Kisha ka nevojë gjithmonë për meshtarë, prandaj kurrë nuk resht së luturi Zotërinë e të korrave që të dërgojë punëtorë në të korrat e veta (krh Mt 9,38). Bashkësia e Seminarit, me në krye formatorët, përbëhet prej 3 bashkësive: bashkësia e propedeutikut, bashkësia e seminarit të lartë dhe bashkësia e vitit të gjashtë ose e diakonave. Secila bashkësi ka ecje të veçantë.

Këtë vit grupi i formatorëve përbëhet nga rektori, Dom Leonardo Falco, meshtar nga Italia, dhe nga zëvendës rektori Dom Kledjan Vukaj, nga dioqeza e Shkodrës, etërit shpirtëror Atë Marino Riti, jezuit nga Italia, dhe Dom Gianfranco Caderelli, misionar italian në Dioqezën e Rrëshenit.

Seminaristët vijnë nga të gjitha dioqezat e Shqipërisë dhe Administraturës Apostolike të Kosovës dhe janë 19 vetë në ecje të ndryshme. Bashkësia e propedeutiku përbëhet prej 4 seminaristëve, 3 nga Shkodra dhe 1 nga Sapa. Bashkësia e seminarit të lartë përbëhet prej 10 seminaristëve, 4 në ciklin e filozofisë, dy në ciklin e teologjisë dhe 4 seminaristë bëjnë një përvojë formative jashtë Seminarit, prej këtyre 4 janë nga Kosova, 3 janë nga Shkodra, 1 nga Lezha, 1 nga Tirana dhe 1 nga Administratura e Jugut.

Bashkësia e Vitit të VI përbëhet prej 5 diakonave. 2 janë nga Shkodra, 1 nga Kosova, a nga Sapa dhe një diakon nga Siçilia (Itali).

Kisha formimin meshtarak e parasheh në katër dimensione: ai njerëzor, themeli i krejt formimit meshtarak, i thirruri të pasqyrojë në vetvete atë rreze të Jezusit që është bërë njeri; shpirtëror, bashkimi me Zotin nëpërmjet Shpirtit Shenjt; intelektual, përbërës i nevojshëm për një njohje më të thellë të mistereve Hyjnore; dhe dimensionin baritor, të shpallim dashurinë e Zotit në mesin e njerëzve. Në fund, dua të lus Zotin për thirrje shenjte, që çdo i ri t'i përgjigjet me guxim dhe pa frikë zërit të Zotit që thërret për ta ndjekur porsia Apostujt.

Alfred Simoni, viti I i Filozofisë

FESTA ME MIQTË E SEMINARIT (03 MARS 2018)

Edhe këtë vit si çdo vit tjetër u zhvillua në ambientet e Seminarit Festa e Mique të Seminarit. Këtë vit kishim shumë arsye të ndryshme për ta festuar me miqtë tanë këtë festë, e cila është shumë e rëndësishme për ne. Duke filluar nga 20-vjetori i inaugurimit të ndërtesës së Seminarit ku në praninë e shumë autoriteteve kishtare dhe civile, u inaugurua ndërtesa e re e Seminarit Ndërdioqezan “Nëna e Këshillit të Mirë”, me seli në Shkodër. Prandaj ky 20-vjetor është një moment për t'i kënduar Hyjit Lavdin tonë, për ta falënderuar për bamirësit tanë dhe për të vazhduar angazhimin tonë me një pasion edhe më të formimin tonë drejtë meshtarisë.

Këtë vit, me rastin e Ditës Kombëtare të Seminarit, kemi reflektuar e medituar mbi identitetin dhe misionin e meshtarit sot, duke marrë si model Famullitarin e Shenjtë të Ars-it, Shën Gjon Maria Vianney, ndërsa kemi kujtuar 200-vjetorin e hyrjes së tij si famullitar. Një njeri i thjeshtë, që e shkriu vetveten për Ungjillin e Dashurisë dhe të Mëshirës. Ku disa nga gjërat më kryesore sipas Shën Gjon Maria Vianney që e karakterizojnë jetën e një meshtari janë: Kërkimi i bashkimit të tij me Hyjin; Kremtimi i Meshës së Shenjtë; Kujdesi dhe qëndresa në rrëfyestore, ku vetë Shën Gjon Maria Vianney rrëfente më shumë se 18 orë në ditë. Karakteristike tjetër e tij është vetëdija e aspektit të jashtëzakonshëm të meshtarisë: Vetëdija se duhej të luftonte me të keqen dhe me të Keqin.

“Suksesi” i tij baritor ka një sekret: Shën Gjon Maria Vianney ishte shumë i devotshëm ndaj Virgjërës së Shenjtë, Nëna e Meshtarisë.

Një karakteristike tjetër ishte kujdesi për më të varfrit. Në orën 9:00 filloi programi artistiko-fetar me këngën e mikpritjes dhe këngë të ndryshme. Pastaj në rrjedhën e kohës u vijua me dëshmi thirrjeje të cilën e bëri Dom Gentian Sema, diakon i Shkodër-Pult, dhe pas dëshmisë së tij ishte edhe momenti i pyetjeve nga ana e pjesmarrësve. Pastaj programi vazhdoi sërish me këngë dhe me valle si dhe u zhvillua drama e përgatitur nga seminaristët mbi jetën e Shën Gjon Maria Vianney.

Në orën 11:30 u kremtua mesha e Shenjtë nga Imzot Simon Kulli, ipeshkvi i parë që ka dalë nga ky seminar. Të pranishëm ishin Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkvi i Shkodër-Pult, dhe shumë meshtarë të tjerë si nga Shqipëria dhe Kosova, ku së bashku me ta kishin ardhur një grup të rinjsh nga famullitë e tyre. Falënderojmë Zotin për të gjithë Miqtë e Seminarit.

Fation Mullarhi, Viti I i Teologjisë

PUNA DHE LUTJA MË NDIHMUAN TË RIGJEJ THIRRJEN TIME

Para se të tregoj diçka lidhur me thirrjen time, dëshiroj në rrallë të parë të falënderoj Autorin e dhuratës së jetës dhe thirrjes sime, ZOTIN.

Quhem Samuel Ramaj, kam lindur në fshatin Stubëll të Epërme, komuna e Vitisë në Kosovë. Vij nga një familje shumë e madhe dhe e shenjtë, jemi nëntë fëmijë, 5 djem dhe 4 vajza, ndërsa unë jam i parafundit, i tetti në radhë.

Si fëmijë, edhe unë kam pasur shumë dëshira, ideale, ëndrra të mëdha për të realizuar. Një nga këto ishte dëshira për t'u bërë një futbollist, ku edhe fillova të stërvitesha dhe të zgjidhesha ndër më

të mirët, së bashku me shokun tim, i cili vazhdon akoma të luajë. Gjatë asaj kohe fillova të ndjej diçka të fort në zemrën time, kur hasa në pjesën më të ëmbël të Besëlidhjes së Vjetër, historia e Samuelit, thosha çfarë domethënë kjo, a do me thërrasë edhe mua Zoti, për çka? Për të zbuluar këtë dhuratë dhe këtë klithje të Zotit në zemrën time të njomë, vazhdova të lutesha pa ndërprerë, edhe në famullinë time nuk munguan njerëz për të më udhëhequr, në fakt shumë meshtarë dhe motra kanë dalë nga kjo famulli, janë 26 meshtar dhe mbi 50 murgesha.

Pas një shqyrtimi të thellë dhe me mbështetjen që më dha familja, vendosa të shkoj në Prizren, tek Seminari i Ulët, për 3 vite. Pastaj vazhdova studimet filozofike-teologjike në Seminarin “Nëna e Këshillit të Mirë”, në Shkodër. Pasi përfundova Propedeutikun dhe dy vitet e filozofisë, fillova ta harroj Zotin, lutesha në mënyrë sipërfaqësore, dhe vendosa të largohesha nga Seminari, jo pse nuk e ndjeja vetën të thirrur, por sepse isha larguar nga burimi i thirrjes, nga Zoti.

Pas këtij vendimi filloi lufta mes dëshirave të mija sipërfaqësore dhe asaj çka unë vërtetë ndjeja në zemrën time. Ishte një luftë mes meje dhe Zotit, thosha: “çka do nga unë o Zot?”. Ishin ditë të errëta që kapluan zemrën time. Kujtoj ditë e net të forta në lutje dhe shamata me Zotin. Gjithçka filloi të qetësohet kur fillova të punoja me vëllezërit, shikoja se sa të gëzuar ishin, nuk ju mungonte asgjë. Puna dhe lutja më ndihmuan të shoh dritë në fund të tunelit. Kthimi në zanafillën e thirrjes sime më ndihmoi të gjeja Zotin, veten e si rrjedhojë vetë Thirrjen time. Zoti më dha paqen që ia kërkoja si dhe kurajon për t'iu përgjigjur edhe një herë, në çdo ditë të jetës sime, me një "PO" të madhe. Tani më i pjekur, me 15 gusht 2016, tek Shenjterorja e Zojës Cerngore, në Letnicë, vendi ku Shenjteresha Nënë Tereza vendosi t'ia kushtojë jetën Zotit, edhe unë, në vitin e shejtërimit të saj, në gjunjë përballë Zojës, vendosa t'ia kushtoj jetën time plotësisht Birit të saj, Jezu Krishtit.

Tani vazhdoj ecjen time me gëzim dhe lumturi drejt meshtarisë, me një vetëdije më të madhe për atë që po bëj dhe kujt po i kushtohem. Për gjithë ecjen time falënderoj formatorët e mi, që pa ndërprerë me ndihmojnë të rritem në aspektin shpirtëror, intelektual, njerëzor dhe baritor. Dhe ju bëj thirrje të gjithë të rinjve që të mos kenë frikë t'i përgjigjen Zotit, sepse dimë që nuk jemi kurrë vetëm, pasi Jezusi vet na ka thënë: “unë jam me ju deri në të sosur të botës” (Mt 28, 19).

Samuell Ramaj, viti II i Teologjisë



... çdo vdekje varfëron

reflektim i redaksisë

Rëndoi shumë opinionin publik lajmi i aksidentit në rrugën e Velipojës pasditën e së dielës, datë 18 shkurt 2018, ku një familje humbi në pak orë 4 anëtarë e mbijetoi për fat vetëm nëna e familjes. Të gjithë u përfshimë nga heshtja dhe imagjinata e dhimbjes. Velipoja në këto ditë të dimrit u bë vendi ku duhej shkuar për të shprehur ngushëllime dhe për t'u solidarizuar me familjen që humbi njerëzit e saj të dashur. Lutje për shpirtin e të vdekurve dhe për jetën e të mbijetuarve ishte mënyra e atyre që nuk munden të bashkoheshin për t'u lutur rreth arkmorteve tejet pikëllues.

Famullitari i Velipojes, dom Marjan Gega, motrat dhe të gjithë bashkëpunëtorët e famullisë ishin aty së bashku me të afërmit e familjes dhe miqtë gjatë ditëve të rënda dhe me shi që po përcilleshin trupat. Arqipeshkvi Imzot Massafra, dy ish famullitarët e meshtarë të tjerë e mijëra njerëz u bashkuna ato ditë në Velipojë. Lutje Zotit e fjalë ngushëllimi për familjen. Mediat folën e shkruajtën mjaft ato ditë.

Kanë kaluar disa javë nga ajo tragjedi. Kujtimi është i freskët. Familjarët me siguri vazhdojnë e qajnë ato humbje. Nëna e asaj familje shpresojmë se po e rimerr vetën duke besuar se vdekja nuk është më e fortë se Zoti i cili e mundi vdekjen. Është e pamundur ta takosh dom Marjan Gegën e të mos sillet biseda për atë tragjedi dhe ti dallon menjëherë sesi fytyra e tij merr një tjetër shprehje, trishtuese. Por jemi në ditë të Pashkëve. Familjarë e miq me siguri do të luten e ndezin qirinj për shpirtrat e të vdekurve.

Por e gjitha kjo tragjedi nuk duhet të kalojë pa reflektuar secili prej nesh sepse kjo mënyrë vdekjeje dhe ai pikëllim nuk janë të natyrshëm. Prandaj dëshiroam që ndërsa jemi në Pashkë e Zoti Jezus na dhuron jetën të reflektojmë sëbashku me ty lexues i dashur mbi vlerën e saj.

A është e drejtë të vdiset ashtu? A i rëndojnë shpoqërisë sonë këto vdekje tragjike? A po bëjmë secili detyrën tonë për të pasur rrugë e qarkullim të sigurtë për të gjithë? A janë të sigurta rrugët tona dhe a punojnë njëmend autoritetet përkatëse që në çdo rrugë të vendit të respektohen standardet e cilësisë së rrugëve dhe rregullat e qarkullimit? S'është fjala këtu vetëm për këtë rast, por edhe për të tjerë të ndodhur apo mos e thash Zoti edhe për të tjerë që mund të ndodhin.

Me lutjet Zotit për shpirtrat e atyre që vdiqën si dhe për Evisan e mbijetuar dhe ngushëllimin që Redaksia i shpreh asaj dhe familjarëve të tyre do të donim në këto rreshta të sensibilizojmë edhe ne për respektimin e jetës, edhe kur udhëtohet. Këmbësorë e shoferë, punojnës të rrugëve e shërbyes të rregullave të qarkullit, së bashku të gjithë mund të mbrojmë jetën nga aksidentet rrugore.

Dhe me disa fjalë nga dy homelitë që mbajti famullitari i Velipojës gjatë dy meshëve të salikimit ju ftojme sërish të lutemi për të vdekurit dhe të reflektojmë.

(



Dom Marjan Gega famullitar i Velipojës



*Nga homelia në funeralin e Edmondit, Ajsel dhe Rajan,
20 shkurt 2018.*

“Vdekja e një fëmije është ndër fazat më të rënda të jetës që një nënë mund të mbajë. Një dhimbje tejmasë e madhe saqë çdo tentative për ta ngushlluar mund të duket e kotë; është e vështirë të gjesh fjalët e duhura për Evisen që solli në këtë botë tre fëmijë e tani nuk i ka më. Kërkon fëmijët e vet, nuk kupton pse burri i saj që e donte aq shumë ka shku në punë e nuk shkon në spital për ta takuar dashurinë e vet.

Evisa jemi duke të gënjer sepse nuk dimë si të të tregojmë, askush prej nesh nuk e merr guximin. Jemi duke u gënjer, ashtu siç e rrejshme është kjo jetë. Jemi duke u treguar të padrejtë me ty, ashtu siç u tregu e padrejtë jeta këto ditë.

Ne nuk kemi fjalë, fjala e fundit i ka mbetur vetëm Jezu Krishtit i cili mund t'u japë jetën e re në qiell fëmijëve dhe burrit tënd. Vetem Ai mund të japë forcën për të filluar një jetë të re: “fëmijët e tu e burri yt nuk janë më këtu, në fakt je ti që nuk i sheh.

Noemi, Aisel, Raian, Edmond nuk duan që ti të mbytesh në lotët e tu, por që ti të besosh, të shpresosh se ata janë në Jetën e vërtetë e ne në atë të rrejshme”.

Nga homelia në funeralin e Noemit, dt. 22 shkurt 2018

“Sot dhimbje u bë edhe më e madhe me largimin tënd Noemi. Deri dje në mëngjes kishim një farë shprese se të paktën ti do të vazhdosh. Sa e deshem këtë e gati gati ia mbushëm mendjen vetes se ti do të mbijetoje në këtë botë. JO! Qielli të deshi për vete edhe ty. Kur dje shkova te klasa jote, moment më të vështirë nuk kishte për mua e për të gjithë. Karrigen tënde s'ta kishte zënë askush, vetëm Kristianën shoqen tënde të ngushtë ta kishte marrë një shoqe e jotja.

E mirë kishte bë se Kristiana nuk mund të rrinte më vetëm me karrigen tënde, ajo të donte ty.

Sot janë të gjithë këtu, të kanë sjellë nga një trëndafil të bardhë, të kanë mbush me lot e trëndafila. Simbol të bukurisë së tyre e të pastërtisë tënde. Ti tashmë sheh prej qiellit. Kot po të flas unë ty. Ndoshta më tepër se të të flas ty, kam nevojë të të dëgjoj se çfarë do të thuash shokëve e shoqeve tuaja, që s'don trëndafila, por kujdesin nga ana e tyre për veten.

Më shumë se një trëndafil, me venë rrypin e sigurimit kur udhëtojmë e t'u thuash prindërve të ulin shpejtësinë, se duhet të ruhem, të mbajmë krahun kur dalim në rrugë që të ruhem nga makinat e mëdha se ata drejtohen nga njerëz të pasur e ne të varfrit ju dukemi si miza”.

aktivitete të ndryshme ...



KRONIKË NGA SHENJËTORORJA E GENAZZANO-S

Viti 2017 ka qenë një vit i pasur me ngjarje: u kremtua më 25 prill 550 vjetori i “Ardhjes” mrekullisht, në Gjenacano, i Figurës së Zojës së Këshillit të Mirë, në Bazilikën e kushtuar Asaj. Dhe më 17 nëntor 2017 u kremtua solemnisht përvjetori i “Kurorëzimit të parë” të Zojës që u bë më 17 nëntor 1682 nga “Capitolo della Basilica di San Pietro” nën Pontifikatin e të Lumit Papë Inoçenti XI. Kremtimi liturgjik i Kurorëzimit ka ringjallur në të gjithë të pranimshmit praninë e Zojës Mari si Mbretëreshë dhe Nënë.

DITA BOTËRORE E TË SËMURËVE DHE PUNONJËSVE TË SHËNDETËSISË
10 SHKURT 2018

Sivjet, tema e Ditës Botërore të të Sëmurëve dhe Punonjësve të Shëndetësisë ishte: “Ja, djali yt Ja nëna jote”. Edhe këtë vit për tu bashkuar me Atin e Shenjtë dhe mesazhin që përcjell në këtë ditë në të gjithë botën, Caritas Dioqezan Shkodër-Pult (sektori i shëndetësisë) të mbështetur nga Arqipeshkvia dhe në bashkëpunim me Famullinë Shën Shtjefni kanë organizuar Ditën Botërore të të sëmurëve dhe punonjësve të shëndetësisë. Në orën 14:30 meshtarë të gatshëm në Katedrale kanë pranuar rrëfimet e të sëmurëve të pranishëm në kishë ndërsa në orën 15:00 është kremtuar Mesha e Shenjtë, me procesionin me të Shenjtërueshmin Sakrament dhe bekimin e të sëmurëve drejtuar nga Imzot Angelo Massafra. Në sallën Mikel Koliqi është organizuar një aktivitet artistik, me protagonistë të rinj e të reja, dhe përshëndetën, Arqipeshkvi, z. Astrit Beci, Drejtor i Shëndetit Publik për Prefekturën Shkodër.

Jolanda Marena



Vizita e NUNCIT APOSTOLIK, Imzot CHARLES BROWN në Famullinë e Jubanit



Më 18 Shkurt, në të dielën e parë të Krezhmes 2018, Famullinë e Jubanit e vizitoi Nuncit Apostolik, Imzot Charles Brown. Në filimin e Meshës së Shejntë famullitari i ka drejtuar Nuncit një mesazh përshëndetës e mirëseardhës. Nga ana e tij, Nunci Apostolik shprehi kënaqësinë e tij që ndodhej mes këtij populli besimtarë. E duke u ndalur mbi liturgjinë e Fjalës ai nxiti fort besimtarët që të bëjnë “luftën” mes të mirës e së keqes. Duke kujtuar martirët e dëshmitarët e fesë në popullin shqipëtarë ai nxiti që kujtimi i tyre duhet të na shtyjnë të gjejmë rrugën e përparimit shpirtëror. Pas Meshës së Shejntë, Nunci ka përshëndetur të gjithë besimëtarët jashtë oborrit të kishës dhe vizitoi shtëpinë e Dom Luigj Kolës, kampin sportiv të “Juban Danja”, shtëpinë e Fratel Gac Jaku, kishën e vjetër si dhe vendet ku ka jetuar hero i Jubanit, Dom Njac Gjoka. Takimi i fundit ishte mbasdite në kishë, ku ka takuar popullin e famullisë.

Dom Giuseppe Barbati

Koncerti i Koreve “Kush Këndon lutet 2 herë”, Edicioni IX

Me rastin e festës së Don Boskos, në kishën e Shenjtë të të rinjve, si çdo vit, më 28 janar është organizuar Koncerti i Koreve. Edicioni i 9 i këtij koncerti erdhi me shumë surpriza. Pjesëmarrës ishin 12 kore të moshave nga më të ndryshmet, disa nga të cilët u prezantuan duke e shoqëruar performancën e tyre me kërcime. Ishin të pranishëm Imzot Angelo Massafra edhe shumë dashamirës të muzikës, prindërit e atyre që këndonin, shumë meshtarë e motra, famullitari i famullisë sonë Don Vlasi. Diçka shumë e veçantë, që i dha ngrohtësinë e duhur koncertit, ishte momenti kur Imzot Angelo Masafra na surprizoi të gjithëve duke marrë harmonikën e duke luajtur në të disa këngë tradicionale. Ne të gjithë kënduam e u bëmë pjesëmarrës të këtij koncerti. E në fund, pas këtyre çasteve gjithëpërfshirëse, Arqipeshkvi ynë na dha bekimin. Koncerti me të vërtetë zgjati më shumë se një orë, por qetësia dhe emocionet e përjetuara janë të paharrueshme.

Paola Qyrsaqi





Armando Cungu

“Sporti në vetvete ka një vlerë të madhe edukative, ndihmon në mirërritjen e njeriut. Ndihejmon në një zhvillim personal me trupin dhe me shpirtin në harmoni, në zhvillim shoqëror, në solidaritet, besnikëri e respekt”

Papa Françesku

Sot në Shqipëri vihet re se 70% të rinjëve po kalojnë më shumë kohë në rrjete sociale apo duke parë televizor se sa duke u praktikuar me sport.

Shumë pak, djem e vajza merren me sport, e pra në këtë moshë, të rinjtë dhe të rejtat, duhet të praktikojnë më shumë sport, pasi ndikon në rritjen harmonike të shëndetit dhe mendjes dhe të trupit.

Studimet thonë se adoleshentët sot në botë duhet të praktikojnë të paktën një orë në ditë sport, jo detyrimisht në fushë futbolli, apo pallat sporti, por mjafton edhe një vrap i lehtë, një shëtitje me biçikletë, apo not në pishinë për t'u çlodhur dhe për të mbajtur trupin në formë.

Mungesa e ushtrimit të sportit sjell mbipeshën trupore, apo probleme të ndryshme shëndetësore, që janë gjithnjë e më shumë të pranishme edhe në rininë tonë shqiptare, deri në sëmundje të cilat po bëhen kronike. Madje edhe vetë prindërit nuk i nxisin shumë fëmijët për t'u marrë me sport, duke harruar se ajo është mënyra më e mirë për t'i larguar nga shumë vese dhe për t'i rritur të shëndetshëm.

Ka nga ata që mendojnë se të jesh sportiv do të thotë të jesh tifoz, por kjo nuk është e vërtetë. Të rinjtë nuk duhet ta shohin sportin vetëm në televizor dhe të ulur në një kolltuk, por ta praktikojnë atë në mënyra të ndryshme, pasi kështu do ta shohin se edhe vetë bëhen protagonistë në jetën e tyre.

Personalisht mendoj se receta për një jetë sa më të mirë është:

* Besimi te Zoti si një mënyrë për të jetuar në paqe dhe në harmoni, frymëzim dhe mbështetje e madhe për çdo besimtarë në jetën e tij.

* Sporti si forma që na e bën jetën më të bukur dhe të shëndetshme.

Sporti në përgjithësi ka një ndikim shumë të madh në formimin e rinisë dhe transmetimin e vlerave të tilla si:

* Largon nga vese të dëmshme: alkooli, droga, bixhozi dhe dembelizmi.

* Ndihejmon që të tejkalohet stresi apo depresioni.

* Forcon tipare pozitive: morale, sociale (rrit socializimin mes njëri-tjetrit dhe punën në grup), humane (bëhen më njerëzorë), guximin, vetë-sakrificën, forcon vullnetin, rrit fuqinë tonë të rezistencës, zhvillon aftësimin e manaxhimit të kohës, të mëson të vendosësh objektiva, të mëson të përballësh me problemet, rrit korrektësinë dhe disiplinën, të bën më të duruar dhe tolerant, etj.

Sporti është një nga aktivitetet më të dobishme dhe më të suksesshme që mund të ju ofrohet falas të rinjve. Ai e rrit kapacitetin njerëzor për të kryer më lehtë punët dhe detyrimet ditore.

Qenia njerëzore instinktivisht është krijesë sociale që kërkon shoqëri nga të tjerët. Ky instinkt pozitiv mund të plotësohet edhe nëpërmjet sportit.

Dua të theksoj faktin që pikërisht sporti transmeton paqe dhe ka forcën që në momentet më të vështira në jetën e njerëzve siç janë luftërat të kontribuojë për ndalimin e tyre, shembuj të tillë kemi plot:

Që në Greqinë e lashtë, ku aso kohe ndodhej në luftë civile dhe mbret ishte Ifitos që jetoi në 800 para Krishtit. Ai ishte i shqetësuar në lidhje me luftën civile në Greqi dhe e pyeti orakullin e Delfit për ndihmë. Orakulli u përgjigj se ai do të

rivendoste paqe me Lojrat Olimpike që i ishte ndaluar më parë. Kur do të zhvilloheshin lojërat ai thërri një armëpushim dhe kështu i dha fund luftërave dhe ato u zhvilluan në qytetin e shenjtë të Zeusit Olimpia.

Raste të tjera ka në vazhdimësi, si në kohën e nazizmit (ndeshja e futbollit) dhe por edhe përgjatë historisë së njerzimit. Shembulli më i fresket është në ditët e sotme dhe konkretisht para pak ditëve në Lojërat Olimpike dimërore ku dy Koretë, ajo e Veiut dhe e Jugut nga tensionet e larta ku pritej të shpërthente lufta nga çasti në çast, u panë të dilnin bashkë krah për krah me një ekip të përbashkët.

Këta shembuj besoj se mjaftojnë për të na treguar e për të kuptuar forcën dhe rëndësinë e sportit në transmetimin e paqes dhe në formimin e njeriut, në veçanti të rinisë.

Një sugjerim praktik nga ana ime për të gjithë ato familjarë apo miq që shohin djaln, vajzën ose një të afërmin e tyre që ka talent në futboll apo fusha të ndryshme sporti, t'i krijojnë mundësinë për ta regjistruar në ekipe të ndryshme që ndodhen në qytetin tonë në mënyrë që fëmija të stërvitet në mënyrë profesionale.

Mos u çuditni nëse fëmija juaj mund të jetë një kampion i madh nesër, historia e sportit ka shembuj të panumërta siç është dhe shembulli i futbollistit të madh Diego Armando Maradona:

Diego Armando Maradona ka lindur me 30 tetor 1960, në Villa Fiorito, një provincë e Buenos Aires (Argjentinë) nga prindërit Don Diego (at) dhe Dalma Salvadora Franco (nëna).

Ai lindi i pesti nga tetë fëmijë në një familje katolike romake.

Maradona u rrit në lagjen e tij të varfër, por të ngushtë familjare.

Familja e tij ishte nga më të varfërat në qytet. Babai i tij Don Diego ishte një murator dhe punëtor në fabrikë duke luftuar për të mbajtur 3 djem e 5 vajza dhe gruan e tij në shtëpi, Dalma.

Megjithatë varfëria nuk ishte një pengesë për suksesin e tij, kontakti i parë me futbollin erdhi kur atij iu dha dhurata e parë një top futbolli nga kushëriri i tij. Kjo ndodhi në ditëlindjen e tij të tretë. Diego i ri flinte me top poshtë këmbës së tij për gati 6 muaj për të shmangur vjedhjen. Ky top ndonjëherë u kap nga nëna e tij, e cila donte që ai të përqëndrohej në studimet për të qenë një kontabilist profesionist. Nuk kishte shumë kohë para se ajo më në fund e kuptoi se futbollit ishte thirrja e tij. Por ishte babai i tij i cili ishte inspirimi dhe që besoj në talentin e tij. Në moshën nëntë vjeçare ai kishte mësuar të luante futboll. Kontakti i tij i parë me një lojë të plotë futbolli ndodhi kur atij i thanë të bashkohej me ekipin e tij të fshatit me emrin "Qepë e vogël". Ndërsa ai ishte me Qepë e Vogël, ai e udhëhoqi ekipin e tij për të fituar 140 lojëra dhe ra në sy për veprim të shkëlqyer të driblimit, asistime të fuqishme, kalime të sakta dhe punë këmbëngulëse mbresëlënëse bëri që Diego Maradona të ngrihej në radhë brenda një periudhe të shkurtër gjatë fëmijërisë së tij.

Aftësitë e tij u vlerësuan nga audienca të cilët ishin të mahnitur kur e shihnin këtë fëmijë të vogël duke vallëzuar në fushat e blerta. Nuk zgjati shumë kohë dhe u botua artikulli i lajmeve të futbollit i cili shkruante: "Kishte një fëmijë me qëndrimin dhe talentin e një ylli". Pas këtyre hapave Maradona njohu vetëm ngritje dhe suksese duke u konsideruar si futbollist më i madh i të gjitha kohërave në futboll.



**Ish futbollist, trainer futbollit*

LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

P. Matteo di Secli

TAKIMET E RINISË DIOQEZANE TË SAPËS

Takimet rinore dioqezane janë një nismë e frymëzuar për një plan 3 vjecar: pro karakterit dhe qenies rinore të krijuar me dashuri, për dashuri dhe për gjëra të larta: "Unë, tjetri dhe Zoti".

Është menduar të punohet dhe krijohet nxitje tek të rinjtë që ta rinjohin veten në dimensionin për të cilin janë të thirrur: të jetojnë mirë me veten, tjetrin dhe Zotin. Duke qenë se secila sferë është e një rëndësie të vecantë për realizimin e secilit, është menduar që secila temë të ketë udhëzimet e nevojshme përgjatë një viti.


Ndërkohë, në mënyrë që gjithcka të jetë jo thjesht në nivel të kuptuari, na vijnë në ndihmë tërheqjet shpirtërore, që të ballafaqojmë me Zotin atë çfarë kemi zbuluar, t'ia ofrojmë atij dhe gjithashtu ta lejojmë që t'i shndërrojë në më të mirën për ne, që ne më pas të shndërrojmë jetën tonë për lavdinë më të madhe të Atij që meriton gjithcka.

Këtij viti kemi dashur t'i japim hapësirën e nevojshme të punës pjesës përbërëse: "Unë dhe vetja". Takimet rreth kësaj teme kanë nisur tashmë. Janë bërë deri tani 2 takime dhe është në organizim e sipër takimi i tretë.

Në takimin e parë është hedhur dritë mbi faktin që ne jemi një mrekulli. "Unë jam një dhuratë". Derisa nuk e konsiderojmë veten të tillë as jeta jonë nuk do të jetë e tillë. E si mund të jetë produkti i mirë në qoftë se inputi nuk është? A e kam pyetur ndonjëherë veten pse ekzistoj? Jam i/e vetëdijshme se sa vlej? Jam e aftë për të pranuar veten? Pse jam kjo që jam, kush ka ndikuar për këtë? Çfarë do të thotë për mua që "Unë jam një dhuratë"?

Në takimin e dytë u mbajt tema "Unë dhe trupi im", që na nxit të unifikojmë mendimet, zemrën, idetë tona me trupin tonë. Si e jetoj një raport kaq të bukur të ekzistencës sime, që më bën të krijoj vepra dhe një realitet të bukur jashtë meje? Anna Nobile, e cila ishte e pranishme në këtë takim, ka sjellë dëshminë e saj, se si nga një kubiste që kërcente ka ndjerë më pas thirrjen dhe ka filluar të jetojë bukurinë e trupit të saj si motër e kushtuar Zotit. Dhe me trupin e saj talentin e saj më të madh e bëri kryevepër të jetës së saj, një shkollë kërcimi arti i të cilës është të lavdërosh Zotin. Një dëshmi vërtetë e bukur dhe e gjallë. Edhe ti i/e re mund të bësh jetën tënde kryevepër edhe me trup, me dhuratat që ke dhe me dhuratën që je.

Nëse pra, të intereson që të jesh i/e formuar në karakterin tënd, të njohësh atë që je, sa mirë mund të relacionohesh me të tjerët dhe të jesh në harmoni me Atë që të do më së shumti; nëse do të kontribuosh në realizimin tënd ka një derë të hapur edhe për ty...3 vite për një përjetësi në dashuri dhe shenjtëri! Sensin jashtë do ta gjesh nëse njeh atë që ti je, nëse njeh brumin tënd. Kështu pra do të jesh një i ri i dobishëm. Zoti na do dhe atëherë mund të kemi gjithçka.



P. Mariano Tarantino ocd

TAKIMI I JUNIOREVE NË NËNSHAT

Në kuadër të nismave për formimin dhe njohjen e ndërsjelltë të motrave të reja (Juniore), para kushteve të përjetshme, nga data 2-4 mars 2018, në Shtëpinë e Lutjes Shën Jozefi, në Karmel të Nënshatit (Shkodër), u mbajt takimi i radhës, nën udhëheqjen e pader Mariano Tarantino-s, karmelitan. Tema e takimit ishte: "Miqësia shpirtërore", e cila i përgjigjej dëshirës së komisionit organizativ për një reflektim dhe një nxitje mbi këtë aspekt, shpeshherë të mënjanuar në ecjen e formimit të motrave.

Tema u zhvillua në një program të mirëfilltë, duke nisur nga aspektet psikologjike dhe shoqërore të miqësisë deri në nivelin shpirtëror, me ungjillin në dorë. Në fillim, udhëheqësi i takimit propozoi një hyrje në temën nëpërmjet tregimit të "Princit të vogël", ku, herë pas here, autori kthehet te tema e miqësisë, e vlerës dhe e vështirësive të saj. Pas kësaj hyrjeje, takimi vijoi me paraqitjen e librit të Aelredit "de Rievaulx", një murg anglez i kohës së mesjetës, i cili ia ka dhuruar literaturës shpirtërore një libër themelor mbi temën e miqësisë shpirtërore. Fjalëve të tij, shumë të urta dhe të lashta, u shtuan edhe mësimet më bashkëkohore në lidhje me aspektet më shoqërore të miqësisë.

Kalimi nga aspektet e përgjithshme të miqësisë në nivelin më shpirtëror, u mundësua falë përvojës dhe mësimave të mësueses së kishës, shën Terezës së Jezusit, për sa i përket lutjes dhe ecjes shpirtërore. Me të u theksuan: së pari, roli i lutjes në jetën e krishterë si çasti më i volitshëm për të përjetuar dhe treguar miqësinë me Jezusin, mikun tejet i mirë, si e thërriste Tereza; së dyti, paraqet aspektin e miqësisë në bashkësitë e rregulltarëve, që sipas saj, realizohet vetëm në marrëdhëniet miqësore të anëtarëve.

Gjithashtu, udhëheqësi paraqiti tiparet e miqësisë së Jezusit, sipas ungjillit, me qëllim që, të përcaktojë një farë "miqësie hyjnore", në të cilën të gjithë të krishterët janë të thirrur. Bëhej fjalë për atë miqësi që Jezusi vetë ushtroi ndaj apostujve dhe njerëzve të tjerë, për atë miqësi që diti të qëndrojë i fortë dhe besnik edhe përballë mohimit dhe tradhëtimit të Pjetrit apo të Judës. Një miqësi, pra, që nuk tërhiqet kurrë dhe që shtrin dorë gjithmonë, i pari.

Në takim morën pjesë 23 juniore, nga kongregata të ndryshme të pranishme në Shqipëri dhe në Kosovë. Grupi u shoqërua nga dy motra të komisionit organizativ, mt. Lila dhe mt. Flora. Sipas programit, motrat juniore patën mundësi edhe për një takim me motrat karmelitane, të pranishme në Nënshat, ku pas një përshëndetjeje me tërë bashkësinë, njëra prej motrave, mt. Mirjam Glavina shtjelloi temën e miqësisë në bashkësi, duke nisur nga mësimet e Terezës së Jezusit dhe nga vetë përvoja e bashkësisë së motrave karmelitane.





REQUIEM ...
Ndoc Gurashi, † 17 Shkurt 2018

Arqidioqeza Metropolitane SHKODËR-PULT



GËZIMI I DËSHMISË

NË BISEDË ME ARQIPESHKVIN
Imzot Angelo Massafra
takon besimtarët e Arqidioqezës

TAKIMET:
Zona 1
Shkodër - Data 5 dhe 6 mars
Zona 2
Beltoja - Data 7 dhe 8 mars
Zona 3
Boriç - Data 12 dhe 14 mars
Zona 4
Juban - Data 15 dhe 16 mars



Takimet do të fillojnë në orën 15.30 (16.30 në Shkodër)



facebook

HAPËSIRË MEDIATIKE

Regjistrohu në kanalin tone!

NgjarjetKishaKatolikeShkoderPult

Do të gjesh video të ngjarjeve
më të rëndësishme të dioqezës



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Dom Gjovalin Sukaj

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqësja
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë